

URDHËR
Nr. 189, datë 4.5.2022

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DEKLARATËS TIP TË
NËNSHKRUAR PREJ PËRKTHYESIT ZYRTAR

(Ndryshuar me urdhër nr. 621, datë 13.12.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
 2. *Deklarata e përkthyesit zyrtar plotësohet, nënshkruhet nga përkthyesi zyrtar dhe vulloset me vulën e tij.*
 3. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira dhe Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
 4. Ngarkohet sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË

DEKLARATA E PËRKTHYESIT ZYRTAR

(Zëvendësuar me urdhër nr. 621, datë 13.12.2024)

Unë, _____, përkthyes/e zyrtar/e i/e gjuhës _____, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate _____, datë _____, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit _____ në gjuhën e synuar _____ me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

Data _____._____._____

Vula dhe nënshkrimi i përkthyesit zyrtar